



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit
University of Prizren
Universiteti Prizren
"UKSHIN HOTI"

Pranuar me dt.	29.11.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-475

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri

Prizren, më 27.11.2019

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, duke vendosur në lidhje me kërkesën për vizitë studimore, parashtruar nga Këshillet Studentore të Fakultetit të Filologjisë dhe të Edukimit, në mbledhjen e mbajtur me datë 13.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa me nr. prot. 04 - 813 të datës 06.11.2019, parashtruar nga Këshillet Studentore të Fakultetit të Filologjisë dhe të Edukimit (Arafat Qafleshi, Kryetar i Këshillit Studentor i Fakultetit të Filologjisë dhe Fatlind Tredhaku, Kryetar i Këshillit Studentor të Fakultetit të Edukimit), për vizitë studimore në qytetin e Manastirit.
- II. Lejohet shfrytëzimi i buxhetit për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit për 100 (njëqind) student, në qytetin e Manastirit për dy ditë (një natë bujtje).
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i UUHP-së që të koordinojë punët lidhur me organizimin e vizitës studimore në qytetin e Manastirit.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh se Kongresi i Manastirit dhe vendimet e tij përbëjnë një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 13.11.2019, pasi shqyrtoi dhe diskutoi kërkesën me nr. prot. 04 – 813 të datës 06.11.2019, parashtruar nga Këshillet Studentore të Fakultetit të Filologjisë dhe të Edukimit, për lejimin e organizimit të një vizite studimore në qytetin e Manastirit, për shenjë të 111 vjetorit të Kongresit të Manastirit, me qëllim të njohjes nga afër të studentëve me dëshmitë historike dhe trashëgiminë kulturore të popullit tonë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues ;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Shërbimit financiar;
- Këshillit Studentor të Fakultetit të Filologjisë dhe të Edukimit;
- Arkivit.

Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri

Kryesues i Këshillit Drejtues

